

## PETICION

Më datë, 28.06.2024

**Drejtuar:** Znj. Lindita Nikolla

**Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë**

**Dërguesi:** Disa studentë të Fakultetit të Drejtësisë, Universitetit Jo-Publik “Epoka”, Tiranë

**Objekti:** *Ushtrimi i kontrollit parlamentar dhe i së drejtës legislative të nismës ligjvënëse për marrjen e masave konkrete, sipas nenit 81 të Kushtetutës së RSH, nga çdo deputet, për hartimin e një ligji të posacëm për rregullimin e Platformave Online dhe shtimin e një dispozite ligjore për publikimin dhe shpërndarjen e fotove apo imazheve filmike me përmbajtje seksualisht eksplicite në Kodin Penal.*

Ne, disa studentë të Departamentit të Drejtësisë Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale pranë Universitetit Epoka, duke marrë shkas nga numri i lartë i rasteve kur platformat online si TikTok, Instagram, Facebook dhe të tjera të ngjashme, kanë shërbyer ndër vite si një mjet i cili bëhet shkak apo ndihmon në kryerjen e një veprë penale duke sjellë pasoja në shoqërinë shqiptare, propozojmë ta adresojmë këtë problematikë në rrugë zyrtare pranë organit legjislativ, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Kjo nismë nxitet nga rastet e fundit mediatike dhe sensitive të cilat kanë sjellë dëmtrim të shëndetit ose humbje të jetës së viktimave, si rrjedhojë e përdorimit të këtyre platformave për qëllime bullizimi, fyerje, kanosje, mashtrimi etj.

Bazuar në nenin 2 pika 2 dhe në nenin 48 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në përputhje me Rregulloren e Brendshme të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, paraqesim këtë Peticion me objekt:

1. Propozimin për marrjen e masave konkrete, sipas nenit 81 të Kushtetutës së RSH, nga çdo deputet, për hartimin e një ligji të posacëm për rregullimin e platformave online
2. Propozimin e shtimit të një dispozite ligjore për publikimin dhe shpërndarjen e fotove apo imazheve filmike me përmbajtje seksualisht eksplicite në Kodin Penal.

### **1. Hartimi i një ligji për rregullimin e operimit të platformave online**

Legjislacioni shqiptar aktual nuk parashikon rregullimin e platformave online. Disa shtete në rajon kanë marrë masa duke hartuar draft ligje dhe ligje për të bërë lundrimin në internet të

sigurt. Në Aktin Digjital të BE-së<sup>1</sup> masat e reja janë krijuar për të goditur përmbajtjen e paligjshme duke përfshirë ngacmimin dhe abuzimin e fëmijëve dhe për të siguruar që të drejtat themelore të njohura me ligj në të gjithë Evropën, duke përfshirë lirinë e shprehjes dhe mbrojtjen e të dhënave.

Ndryshimi dhe krijimi i një legjislacioni për platformat dixhitale në BE erdhi pas vetëvrasjes së një vajze 14 vjecare<sup>2</sup>, ndërsa në Shqipëri rastet e vetvrasjeve të shkaktuara nga gjuha e ashpër, cënimi i dinjitetit, dhuna psikologjike e përdorur në platformat dixhitale janë të shumta, por ende nuk është marrë asnjë masë.

Në mbështetje të nenit 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, propozojmë marrjen e masave konkrete nga ana e të paktën 1 deputeti për të propozuar një projektligj, i cili duhet të ketë si qëllim përcaktimin e të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësisë të autoriteteve publike dhe subjekteve private në lidhje me mbrojtjen e individëve nga përdorimi i platformave online, zhvillimin e sistemeve të infrastrukturës së informacionit, detyrimin e këtyre autoriteteve për respektimin e standardeve të sigurisë elektronike si dhe përcaktimin e rregullave për ofrimin e platformave online në mënyrë sa më të sigurt. Rregullimi i fushës përkatëse lidhet me mbrojtjen e përdoruesve, të mitur dhe të rritur, së bashku me mundësinë për të patur mbështetjen e duhur nga autoritetet përkatëse që do të vijë në jetë për implementimin dhe ekzekutimin e këtij ligji.

Detyrimet e autoriteteve publike në kontrollin e këtyre platformave elektronike vlerësojmë se duhet të përfshijnë monitorimin dhe zbatimin e rregullave të përcaktuara për të garantuar respektimin e ligjit dhe mbrojtjen e përdoruesve. Funksonimi i ndërveprimeve midis autoriteteve publike dhe subjekteve private për mbrojtjen e individëve nga rreziqet potenciale në platformat online është thelbësore për parandalimin dhe menaxhimin e incidenteve të sigurisë. Krijimi i një autoriteti përgjegjës për zbatimin e këtij projektligji do të sigurojë një mekanizëm efektiv për verifikimin dhe trajtimin e ankesave të përdoruesve, duke garantuar një mjedis online më të sigurt dhe të besueshëm për të gjithë.

Ne propozojmë, së bashku me hartimin e këtij ligji dhe krijimin e një organi i cili do të ketë autoritetin për të rregulluar përmbajtjen e shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike, si dhe të jetë në kontakt të vazhdueshëm me kompanitë që zotërojnë platformat për rregullime specifike dhe sjelljet e përdoruesve. Për të gjitha rastet që këto subjekte kryejnë shkelje, ky autoritet të mund të marrë masa kundrejt shkelësve. Në këtë mënyrë do të sigurohet ruajtja e sjelljeve etike dhe mbarëvajtja e platformave online. Duke marrë shkas dhe nga

---

<sup>1</sup> Regulation (EU) 2022/2065 of the European Parliament and of the Council of 19 October 2022 on a Single Market For Digital Services and amending Directive 2000/31/EC (Digital Services Act) (Text with EEA relevance) [2022] OJ L 277/1. Për një vështrim të përgjithshëm shiko Commission, Digital Services Act &lt;<https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/digital-services-act-package>&gt;

<sup>2</sup> Adams, C. (2022) *Encouraging self-harm to be criminalised in Online Safety Bill*, BBC News. Available at: <https://www.bbc.com/news/uk-63768496>.

vende të tjera të Bashkimit Europian të tilla si: Austria, Gjermania dhe Franca, ky ligj do të duhet të përfshijë rregullime dhe sanksione për shkeljet sipas masave që do të caktohen.<sup>3</sup>

### **3. Propozim për shtimin e një dispozite për publikimin dhe shpërndarjen e fotove apo imazheve filmike me përmbajtje seksualisht eksplicite në Kodin Penal**

Sugjerojmë marrjen e masave për shtimin e një dispozite në Kodin e ri Penal në lidhje me publikimin dhe shpërndarjen e fotove apo videove private, me përmbajtje seksuale eksplicite, pa pëlqimin e personit të përfshirë në të.

Ky propozim vjen si rezultat i një fenomeni gjithmonë e me shumë në rritje nëpër rrjetet sociale i cili konsiston në publikimin ose kërcënimin për publikim dhe shpërndarje, të fotove apo videove që shfaqin persona të angazhuar në aktivitete seksuale, në poza seksualisht eksplicite, me gjenitalet e ekspozuara, pamje në të cilat ajo që shikohet nuk kishte për qëllim të publikohej, pra pa pëlqimin e personit të përfshirë. Kjo është shpesh përgjigje e një ndarjeje, pra një hakmarrje nga një ish-bashkëshort, bashkëjetues apo nga një person me të cilin viktimja ka pasur marrëdhënie emocionale. Një fenomen poshtërues i imazhit dhe dinjitetit, që mund të kushtëzoj jetën e viktimës. Në dispozitat ekzistuese të Kodit Penal, në seksionin VI, kreu II, parashikohen krime seksuale që lidhen me aktin seksual në rrethana të ndryshme dhe në seksionin VIII, kreu II, për veprat morale kundër moralit dhe dinjitetit, ndalesa i referohet pornografisë. Pornografia ndalon prodhimin, shpërndarjen, reklamimin, importimin, shitja e botimi i materialeve pornografike në prani të fëmijëve dhe rrethana të ndryshme të parashikuara nga neni 117 i Kodit Penal në fuqi, por kjo dispozitë ashtu si ato të cituara më lart nuk dënojnë veprën penale me karakter hakmarrës, ku viktimja në mirëbesim dhe pa qëllimin për të bërë publike këto imazhe, ia dërgon një personi të besuar.

Një sërë shtetesh anëtare të Bashkimit Europian kanë ligje specifike që e ndalojnë këtë gjë. E më konkretisht, nga analiza e ndërmarrë prej nesh, sjellim në vëmendjen tuaj si shembuj pozitiv Italinë. Italia dënon drejtëpërdrejtë me anë të një kuadri specifik ligjor<sup>4</sup> për këtë fenomen, duke marrë shkas nga rastet e shumta që lidhen me këtë veprë. Me anë të këtij parashikimi është arritur të ketë një mbrojtje të shtuar në përdorimin e internetit si dhe një mbështetje për viktimat e kësaj vepre.

---

<sup>3</sup> Më 1 Janar 2021 hyri në fuqi Akti i Platformave të Komunikimit i Austrisë (Kommunikationsplattformen-Gesetz), i cili kërkon që platformat online të regjistrojnë përdoruesit dhe të gjurmojnë gjuhën e urrejtjes dhe autorët e tyre. Në janar të vitit 2018, Gjermania ka miratuar ligjin NetzDG, i cili parashikon se kompanitë e mediave online do të fshijnë cdo postim të pahijshëm në mënyrë urgjente brenda 24 orësh ose maksimumi brenda 7 ditësh, pasi në rast të kundërt do të përballen me gjopa në shuma mbi 50 milionë euro. Në maj të vitit 2020, Franca miratoi ligjin Avia i cili detyroi platformat online që për 24 orë të fshijnë publikimet që nxisin urrejtje apo përmbajnë fyerje diskriminuese për shkak të racës fesë, përkatësisë etnike, gjinisë, orientimin seksual apo paaftësinë.

<sup>4</sup> Testo del Regio Decreto 19 ottobre 1930, n. 1398 aggiornato alla L. 29 aprile 2024, n. 56, Codice Penale (Kodi Penal Italian) Neni 612-ter, mbi shpërndarjen e fotove apo videove seksualisht eksplicite.

Në Kodin Penal në fuqi në vendin tonë viktimë do mund të referohej parashikimeve të përmendura më lart në legjislativin penal, por në asnjërin prej tyre nuk do të gjendej zgjidhje direkte mbi këtë problematikë.<sup>5</sup>

Nga ky vakum ligjor lind nevoja e një rregullimi specifik që të dënojë këto lloje sjelljesh, në një mënyrë që ti vihet fundi këtij fenomeni dhe pasojave që vijnë me të, të cilat shpeshherë kanë qenë dhe fatale për shëndetin e jetën. Formulimi i kësaj dispozite synon të dënojë autorët e kësaj sjelljeje, duke përfshirë jo vetëm ato persona që i publikojnë fotot apo videot private me këtë lloj përmbajtjeje, por dhe ato që i shpërndajnë pa asnjë autorizim. Viktimës do ti bëhet e mundur të kërkojë dënim për autorin e krimit dhe shpërblim për të gjitha dëmet e shkaktuara. Do të mbajnë përgjegjësi në mënyrë tangente dhe rregulluesit e platformave dhe aplikacioneve nëpërmjet të cilave kryhet akti, që në fund të arrihet asgjësimi dhe fshirja e menjëhershme e fotove të inkriminuara.

Në themel, theksohet synimi për futjen e një dispozite në Kodin Penal për “Publikimin dhe shpërndarjen e imazheve apo videove private seksualisht eksplicite”, për të dhënë fund këtij fenomeni kaq të përhapur sot.

Gjithashtu, në mbështetje të këtyre mendimeve, po ndajmë me ju një Raport Analitik i cili përmban një analizë të mirëfilltë të kuadrit ligjor vendas dhe atij evropian, duke nxjerrë në pah praktikatat më të mira e pozitive që vlen të huazohen.

Duke ju falenderuar për kohën, mbetemi në pritje të informimit mbi hapat e ndërmarrë për adresimin e këtyre mendimeve.

Me respekt!

1. Arba Xhani
2. Bethni Levendi
3. Greta Deliallisi
4. Katerina Cela
5. Lea Kryeziu
6. Leonardo Bezhi
7. Gentjan Skara
8. Oresta Xhengo
9. Vesa Muka

---

<sup>5</sup> Ligji nr 7895, datë 27.01.1995, ‘Kodi Penal I Republikës së Shqipërisë’ [1995] FZ 2 i ndryshuar për here të fundit me Ligjin nr 20, datë 3.4.2024.